



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

SHËRBIME USHQIMI DHE PIJE

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²

G10-III-24

Tiranë, 2024

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtja

Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi	4
Kohëzgjatja	4
Qëllimi:	4
Kriteret e përgjithshme të pranimi:	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	4
Ofruesit	4
Data e validimit	4
Data e miratimit	4
Variantet e mëparshme	4
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT	5
Kompetenca të përgjithshme	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:	5
NjN-07-III-0158-24 Planifikimi dhe organizimi i punës në shërbime ushqimi dhe pije	5
Rezultatet e të nxënit në njohuri	5
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	6
Kriteret e vlerësimit	6
NjN-07-III-0159-24 Njohuri për pijet	6
Rezultatet e të nxënit në njohuri	7
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	7
Kriteret e vlerësimit	7
NjN-07-III-0086-24 Përgatitja dhe shërbimi i pijeve në bar	7
Rezultatet e të nxënit në njohuri	7
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	8
Kriteret e vlerësimit	8
NjN-07-III-0087-24 Shërbimi i pijeve dhe ushqimit në restorant	9
Rezultatet e të nxënit në njohuri	9
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	9
Kriteret e vlerësimit	9
NjN-07-III-0012-24 Shërbime speciale në sy të klientit	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	10
Kriteret e vlerësimit	10
NjN-07-III-0091-24 MICE dhe organizimi i aktiviteteve të tjera	11
Rezultatet e të nxënit në njohuri	11
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	11
Kriteret e vlerësimit	11
NjN-07-III-0160-24 Bazat e kuzhinës	12
Rezultatet e të nxënit në njohuri	12
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	12
Kriteret e vlerësimit	12
NjN-07-III-0082-24 Të ushqyerit	13
Rezultatet e të nxënit në njohuri	13
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	13
Kriteret e vlerësimit	13
NjN-23-III-0013-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere	14
Rezultatet e të nxënit në njohuri	14

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	14
Kriteret e vlerësimit.....	14
NjN-07-III-0081-24 Anglishte teknike	15
Rezultatet e të nxënit në njohuri	15
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	15
Kriteret e vlerësimit.....	15
NjN-07-III-0161-24 Matematika e aplikuar.....	16
Rezultatet e të nxënit në njohuri	16
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	16
Kriteret e vlerësimit.....	16
NjN-22-III-0014-24 Komunikimi dhe etika profesionale.....	17
Rezultatet e të nxënit në njohuri	17
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	17
Kriteret e vlerësimit.....	17
NjN-07-III-0162-24 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në shërbimin e ushqimeve dhe pijeve	17
Rezultatet e të nxënit në njohuri	17
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	18
Kriteret e vlerësimit.....	18
NjN-07-III-0015-24 Siguria ushqimore dhe garantimi i cilësisë	18
Rezultatet e të nxënit në njohuri	18
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	19
Kriteret e vlerësimit.....	19
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:	19
Modalitetet e vlerësimit.....	20
Informacion shtesë.....	20
SHËNIM.....	21

Emërtimi i kualifikimit	SHËRBIME USHQIMI DHE PIJE			Kodi
Kohëzgjatja	2800-3300 orë ³	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	G10-III-24
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional “Shërbime ushqimi dhe pije” niveli III-të në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është të përgatisë punonjës të kualifikuar për shërbimet që ofrohen në struktura akomoduese dhe restorante apo për krijimin e një biznesi privat, si dhe të zhvillojë personalitetin e individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në “Shërbime ushqimi dhe pije”, niveli III-të në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: kanë mbaruar arsimin e detyruar; janë në gjendje shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Shërbime ushqimi dhe pije”, niveli III-të në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës të punonjësit të kualifikuar në këtë fushë. Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t'i drejtohet tregut të punës për punësim në industrinë e mikpritjes si: resort, hotel, motel, bujtina, fjetina, restorant, bar, qendër kurative, agroturizëm, kroçere, në industrinë e kateringut si dhe në veprimtari të tjera që ushtrohen në këtë drejtim. Gjithashtu, individ i mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e shërbimeve të mikpritjes. Me përfundimin e kualifikimit profesional “Shërbime ushqimi dhe pije”, niveli III-të në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individ ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin IV të KSHK, referuar nivelit IV të KEK, si teknik/menaxher i mesëm. Me arsimim të mëtejshëm individ fiton të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme				

³ orë mësimore 45 min.

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional “Shërbime ushqimi dhe pije”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individit duhet të zotërojë njohuritë, shprehjet profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas fushave të mëposhtme:

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitet e të nxëniet.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
3. Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
5. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
6. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
7. Të organizojë drejt procesin e të nxëniet të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
8. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
9. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
10. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
11. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
12. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
13. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
14. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet.
15. Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kriteret e drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij, për t'u përshtatur me evolucionin teknologjik.

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxëniet (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

NjN-07-III-0158-24 Planifikimi dhe organizimi i punës në shërbime ushqimi dhe pije

Rezultatet e të nxëniet në njohuri

1. Të shpjegojë strukturën organizative të departamentit Ushqim dhe Pije (F&B).
2. Të shpjegojë detyrat e personelit të departamentit Ushqim dhe Pije (F&B) sipas hierarkisë së organizimit;
3. Të shpjegojë mënyrën dhe funksionimin e departamentit Ushqim dhe Pije (F&B);
4. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit dhe ndarjes së detyrave në vendin e punës;
5. Të shpjegojë rregullat e veshjes dhe mirëmbajtjes të uniformës së shërbimit;
6. Të dallojë konceptet: plan prodhimi, menu, recetë dhe recepturë;

7. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit dhe menaxhimit të burimeve të nevojshme;
8. Të listojë mjetet, pajisjet dhe serviset që përdoren në departamenti F&B;
9. Të përshkruajë mënyrat e pastrimit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve të punës;
10. Të shpjegojë mënyrën e hartimit/plotësimit të fletëporosisë;
11. Të shpjegojë mënyrat e sistemimit të mjeteve, pajisjeve dhe lëndëve të para e ndihmëse;
12. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të gatishmërisë së pajisjeve të punës;
13. Të argumentojë rëndësinë e kryerjes së parapërgatitjeve (mise en place) në vendin e punës;
14. Të shpjegojë mënyrat e bashkëpunimit dhe koordinimit të veprimtarive me të tjerë;
15. Të shpjegojë mënyrat dhe formatet e raportimit;
16. Të shpjegojë rëndësinë e kryerje së matjeve dhe peshimeve të lëndëve të para dhe ndihmëse në bar;
17. Të shpjegojë rëndësinë e inventarizimit të mjeteve, pajisjeve dhe materialeve të punës;
18. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të dokumentacionit gjatë veprimtarisë në departamentin e Ushqimit dhe Pijes (F&B);
19. Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes dhe arkivimit të dokumentacionit në departamentin e Ushqimit dhe Pijes (F&B);
20. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë gjatë veprimtarisë në departamentin F&B;
21. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të elementeve të dizajnit dhe estetikës në departamentin F&B.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të organizojë punën dhe vendin e punës;
2. Të planifikojë burimet e nevojshme për proceset e punës;
3. Të kryejë dokumentimin dhe raportimin e punës.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton rregullat e veshjes dhe mirëmbajtjes të uniformës së shërbimit sipas rregullores.
- Zbaton detyrat e personelit të departamentit Ushqim dhe Pije (F&B) sipas hierarkisë së organizimit.
- Ndan detyrat e stafit në varësi sipas proceseve të punës.
- Planifikon mjetet, pajisjet dhe lëndët e para e ndihmëse sipas proceseve të punës;
- Përdor mjetet, pajisjet dhe lëndët e para e ndihmëse sipas proceseve të punës;
- Mat dhe peshon lëndët e para dhe ndihmëse sipas rregullit;
- Sistemon mjetet, pajisjet dhe lëndët e para e ndihmëse sipas standardit;
- Pastron dhe mirëmban mjetet dhe pajisjet e punës sipas standardit;
- Inventarizon mjetet, pajisjet dhe materialet e punës sipas rregullit;
- Kontrollon funksionalitetin e pajisjeve të punës sipas manualit;
- Përdor sistemet dhe pajisjet kompjuterike software dhe hardware, sipas udhëzimit/manualit.
- Përdor pajisjen POS për marrjen e pagesave sipas udhëzimeve/manualit.
- Harton/plotëson fletëporosinë sipas formatit;
- Përdor konceptet: plan prodhimi, menu, recetë dhe recepturë;
- Kryen parapërgatitjet (mise en place) në vendin e punës sipas rregullit;
- Bashkëpunon dhe koordinon veprimtaritë me të tjerë sipas rregullores së brendshme;
- Kryen raportime tek eprori sipas formatit/rregullit;
- Përdor rregullisht dokumentacionin teknik gjatë veprimtarisë në departamentin e Ushqimit dhe Pijes (F&B).
- Ruan dhe arkivon dokumentacionin në departamentin e Ushqimit dhe Pijes (F&B) sipas rregullit.
- Përdor elementë të dizajnit dhe estetikës në departamentin F&B, sipas rregullit.

NjN-07-III-0159-24 Njohuri për pijet

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të listojë dhe klasifikojë pijet;
2. Të dallojë llojet e ujit, veçoritë dhe karakteristikat e tij;
3. Të shpjegojë veçoritë e lëngjeve të frutave dhe perimeve;
4. Të shpjegojë veçoritë e pijeve freskuese;
5. Të listojë llojet e pijeve të ngrohta dhe të ftohta;
6. Të përshkruajë historinë e prodhimit të kafesë, kakaos, çajit (alkaloidët) dhe origjinën e tyre;
7. Të shpjegojë karakteristikat e llojeve të ndryshme të kafesë, kakaos dhe çajit;
8. Të listojë llojet e pijeve të përgatitura me bazë kafeje, kakao dhe çaji;
9. Të listojë pijet jo alkoolike sipas kategorive të tyre;
10. Të listojë pijet alkoolike sipas kategorive të tyre;
11. Të listojë llojet e distilateve dhe karakteristikat e tyre;
12. Të shpjegojë kuptimin për aperitivët dhe digestivët, veçoritë e tyre;
13. Të dallojë veçoritë e birrës, sipas llojit dhe rajonit;
14. Të dallojë veçoritë e verës, sipas llojit dhe rajonit;
15. Të shpjegojë karakteristikat e verës së gazuar (spumante);
16. Të shpjegojë metodën e prodhimit dhe karakteristikat e shampanjës;
17. Të përshkruajë mënyrën e kombinimit të ushqimit me verën;
18. Të interpretojë etiketën e pijeve alkoolike dhe jo alkoolike.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të dallojë pijet alkoolike nga jo alkoolike.

Kriteret e vlerësimit

- Identifikon pijet alkoolike, sipas llojit;
- Klasifikon pijet jo alkoolike, sipas llojit;
- Klasifikon llojet e kafesë, kakaos dhe çajit, sipas karakteristikave dhe varietetit;
- Klasifikon llojet e kafesë, sipas pjekjes;
- Klasifikon llojet e kafesë, kakaos dhe çajit, sipas origjinës;
- Klasifikon llojet e ujit, sipas veçorive dhe karakteristikave;
- Klasifikon pijet freskuese, sipas veçorive;
- Klasifikon distilatet, sipas karakteristikave;
- Klasifikon digestivët dhe aperitivët sipas veçorive;
- Klasifikon birrën, sipas rajonit dhe llojit;
- Klasifikon verën, sipas rajonit dhe llojit;
- Klasifikon verën e gazuar (spumante), sipas karakteristikave;
- Klasifikon shampanjën, sipas metodës së prodhimit dhe karakteristikave;
- Klasifikon etiketat, sipas standardit.

NjN-07-III-0086-24 Përgatitja dhe shërbimi i pijeve në bar

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë mënyrën e vendosjes së barit në hapësirë;
2. Të listojë llojet e barit sipas karakteristikave të tyre;
3. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e një bari;

4. Të shpjegojë rregullat e qëndrimit në bar;
5. Të shpjegojë rregullat e mirëpritjes së klientit në bar;
6. Të përshkruajë rregullat e marrjes së porosisë;
7. Të shpjegojë ndërtimin dhe funksionimin e ekspresit dhe mullirit bluarës;
8. Të përshkruajë mënyrat e bluarjes së kafesë;
9. Të shpjegojë teknikat e dekorimeve të pijeve që përgatiten në bar;
10. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të produkteve organike dhe sezonale në bar;
11. Të shpjegojë mënyrën e hartimit të listës së pijeve dhe interpretimin e tyre;
12. Të përshkruajë rëndësinë e parapërgatitjes së sallës për shërbim;
13. Të përshkruajë teknikat e përgatitjes së qumështit kremoz;
14. Të përshkruajë logjikën e kombinimit të pijeve;
15. Të shpjegojë teknikat/metodat e përgatitjes së pijeve të ngrohta/të ftohta;
16. Të përshkruajë teknikat/metodat e përgatitjes së pijeve mikse/kokteileve;
17. Të përshkruajë rëndësinë e kreativitetit në bar;
18. Të përshkruajë mënyrën e kombinimit të gotës me pijen;
19. Të përshkruajë mënyrat e dekorimit të pijeve në bar;
20. Të listojë llojet e akullit dhe përdorimin e tyre në bar;
21. Të përshkruajë mënyrën e kombinimit të pijeve me produkte shoqëruese;
22. Të përshkruajë mënyrat e shërbimit të pijeve në banak dhe bar;
23. Të shpjegojë rregullat e përcjelljes së klientit në bar;
24. Të shpjegojë rëndësinë e marrjes së përshtypjeve nga klienti;
25. Të përshkruajë rëndësinë e performacës/show-t në bar;
26. Të shpjegojë procedurat e shërbimit për klientët VIP në bar.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë procedurat e përgatitjes së pijeve të ndryshme në bar;
2. Të zbatojë procedurat e përgatitjes së ushqimeve shoqëruese për pijet;
3. Të zbatojë procedurat e shërbimit të pijeve në banak/bar;
4. Të zbatojë procedurat e shërbimit të ushqimeve shoqëruese për pijet.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton rregullat e qëndrimit në bar;
- Zbaton rregullat e mirëpritjes së klientit në bar;
- Merr porosinë në banak/bar duke respektuar rregullat e komunikimit me klientin;
- Kontrollon gjendjen e banakut sipas udhëzimeve përkatëse;
- Kontrollon cilësinë dhe sasinë e lëndëve të para dhe ndihmëse sipas standardit përkatës.
- Merr në dorëzim lëndët e para dhe ndihmëse sipas rregullit;
- Sistemon lëndët e para dhe ndihmëse sipas rregullave të magazinimit;
- Parapërgatit në kohë sallën për shërbim sipas rregullores së brendshme;
- Mirëmban mjetet e punës dhe pajisjet në banak sipas rregullores së brendshme;
- Mbikëqyr pastrimin dhe dezinfektimin e mjeteve të punës sipas standardit përkatës.
- Inventarizon paraprakisht mjetet e punës dhe bazën materiale sipas udhëzimeve përkatëse.
- Mat lëndët e para dhe ndihmëse, sipas llojit të pijes.
- Përgatit pije me bazë kafeje sipas teknikave përkatëse;
- Përgatit pijet me bazë kafeje me alkool sipas recepturës;
- Përzgjedh akullin sipas llojit të pijes;
- Përgatit pije me metodën shaker sipas teknikës dhe recepturës;

- Përgatit pije me gotën përzierëse sipas teknikës dhe recepturës;
- Përgatit pije direkt në gotën e klientit sipas teknikës dhe recepturës;
- Përgatit pije me metodën muddler (shtypje) sipas teknikës dhe recepturës;
- Përgatit pije me blender/mikser sipas recepturës;
- Dekoroni pijet duke respektuar rregullat e estetikës;
- Përzgjedh gotat, shishet dhe shaker-at e përshtatshëm sipas formës dhe vëllimit të lëngut në të;
- Realizon performacë/show me mjetet sipas rregullave përkatëse;
- Përgatit produktet shoqëruese sipas llojit të pijeve;
- Shërben pijet në banak/bar sipas rregullit;
- Merr përshtypjet nga klientët për shërbimin në banak/bar sipas standardit;
- Përcjell klientin sipas rregullit.

NjN-07-III-0087-24 Shërbimi i pijeve dhe ushqimit në restorant

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e mikpritjes së klientëve në restorant;
2. Të shpjegojë rëndësinë e skicimit artistik të sallës së restorantit.
3. Të shpjegojë mënyrën e hartimit dhe skicimit të menu-së së ushqimeve;
4. Të argumentojë logjikën e renditjes së ushqimeve në menu;
5. Të shpjegojë mënyrën e hartimit dhe skicimit të listës/kartës së pijeve;
6. Të shpjegojë mënyrën e organizimit profesional të Side Board në restorant;
7. Të listojë llojet e mëngjeseve sipas karakteristikave të tyre;
8. Të shpjegojë rëndësinë e prezantimit të menu-së të klientët dhe sugjerimit të ushqimit dhe pijeve;
9. Të shpjegojë rregullat e marrjes së porosisë të klientëve në restorant;
10. Të listojë metodat e shërbimit në restorant;
11. Të shpjegojë mënyrën e shtrimit të tavolinës sipas menu-së;
12. Të shpjegojë mënyrën e shërbimit në dhomën e klientit;
13. Të përshkruajë metodat e shërbimit të pijeve në restorant;
14. Të shpjegojë procedurat e shërbimit për klientët VIP në restorant.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë rregullat e përgatitjes së sallës dhe shtrimit të tavolinës;
2. Të zbatojë procedurat e shërbimit të pijeve dhe ushqimit në restorant.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton rregullat e mikpritjes së klientëve në restorant, sipas standardit;
- Zbaton procedurat e shërbimit të mëngjeseve sipas karakteristikave të tyre;
- Shërben mëngjesin Continental, sipas procedurave standarde;
- Shërben mëngjesin bufe, sipas procedurave standarde;
- Shërben mëngjesin A la carte, sipas procedurave standarde;
- Shërben brunch-in, sipas procedurave standarde;
- Organizon në mënyrë profesionale Side Board në restorant, sipas procedurës;
- Harton dhe skicon menu të thjeshtë të ushqimeve;
- Harton dhe skicon një listë/kartë të thjeshtë të pijeve;
- Shtron tavolinën sipas menu-së dhe metodës së shërbimit;
- Shoqëron klientët në restorant sipas rregullave;

- Prezanton menu-në te klientët, sipas rregullit;
- Sugjeron ushqim dhe kombinimin me pije te klientët sipas rregullit;
- Merr porosinë e klientëve në restorant sipas rregullit;
- Shërben në restorant, sipas metodave të shërbimit;
- Shërben në dhomën e klientit, sipas rregullit;
- Zbaton metodat e shërbimit të pijeve në restorant;
- Merr pagesën nga klientët, sipas mënyrës së pagesës;
- Zbaton procedurat e shërbimit për klientët VIP në restorant sipas standardit;
- Kryen skicimin artistik të sallës së restorantit sipas rregullit.

NjN-07-III-0012-24 Shërbime speciale në sy të klientit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë llojet e shërbimeve speciale në sy të klientit dhe mënyrat e realizimit të tyre;
2. Të shpjegojë llojet e mjeteve dhe pajisjeve të punës që nevojiten për shërbimet speciale në sy të klientit;
3. Të përshkruajë rregullat e parapërgatitjes së gueridon-it për shërbime speciale;
4. Të shpjegojë teknikat e filetimit të frutave sipas llojit të tyre;
5. Të shpjegojë teknikat e filetimit të peshkut sipas mënyrës së gatimit;
6. Të shpjegojë teknikat e filetimit të shpendëve në sy të klientit;
7. Të shpjegojë teknikat e prerjes së mishrave sipas llojit;
8. Të shpjegojë teknikat e prerjes së djathërave dhe proshutave sipas llojit;
9. Të shpjegojë teknikat e realizimit të produkteve që flakërohen (flambé);
10. Të shpjegojë teknikat e realizimit të ëmbëlsirave në gueridon;
11. Të shpjegojë rëndësinë e kompozimit të pjatës;
12. Të shpjegojë mënyrat e kombinimit të përbërësve për dressing;
13. Të shpjegojë teknikat e përgatitjes së sallatave dhe marinimit të tyre në sy të klientit;
14. Të shpjegojë rëndësinë e realizimit të shërbimeve të tjera speciale në sy të klientit;
15. Të listojë shërbimet speciale në sy të klientit dhe mënyrat e realizimit të tyre.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të realizojë shërbime speciale në sy të klientit.

Kriteret e vlerësimit

- Përdor mjetet dhe pajisjet për shërbimet speciale në sy të klientit sipas llojit të shërbimit;
- Parapërgatit karrocën e shërbimit (gueridonin) sipas rregullit;
- Realizon shërbimet speciale në sy të klientit, sipas llojit;
- Fileton peshqit në sy të klientit sipas teknikës përkatëse;
- Fileton shpendët në sy të klientit sipas rregullit;
- Fileton frutat në sy të klientit sipas llojit;
- Racionon/fileton mishrat sipas llojit dhe sasisë;
- Përgatit pjatë të para në sy të klientit sipas recetës;
- Përgatit pjatë kryesore në sy të klientit sipas recetës;
- Përgatit ëmbëlsira në sy të klientit sipas recetës;
- Përgatit produkte të flakëruara (Flambim) në sy të klientit sipas rregullit;
- Komponon pjatën në mënyrë estetike sipas rregullit;

- Përgatit dressing sipas recetave përkatëse;
- Marinon sallatat në sy të klientit sipas recetës;
- Realizon shërbime të tjera speciale në sy të klientëve sipas recetës.

NjN-07-III-0091-24 MICE dhe organizimi i aktiviteteve të tjera

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë llojet e organizimit të aktiviteteve MICE (Meeting, Incentive, Conference and Exhibition) dhe aktiviteteve të tjera;
2. Të shpjegojë rëndësinë e organizimit të aktiviteteve MICE, bazuar në gjenerimin e të ardhurave për kompaninë;
3. Të argumentojë rëndësinë e hartimit të planit dhe objektivave nga planifikimi fillestar deri në përfundimin me sukses të aktivitetit, sipas pritshmërisë të klientit;
4. Të argumentojë rolin e bashkëpunimit me sukses midis departamenteve dhe sektorëve, për të përmbushur objektivat e planifikuara;
5. Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit me klientët sipas kërkesave të detajuara për aktivitetin (afatet kohore, sallën, detyrimet ligjore dhe buxhetet), sipas politikave të kompanisë;
6. Të argumentojë rëndësinë e kryerjes së bisedave të suksesshme për shitje gjatë komunikimit me klientët;
7. Të shpjegojë mënyrën e plotësimit dhe shpërndarjes së fletëve funksionale (functional sheets) tek departamentet dhe sektorët e tjerë, për organizimin e aktiviteteve;
8. Të shpjegojë rëndësinë e organizimit të sallës, sipas llojit të aktivitetit dhe numrit të pjesëmarrësve;
9. Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të elementeve të dizajnit dhe të estetikës në dekorimin e sallës dhe tavolinave, sipas llojit të aktivitetit;
10. Të argumentojë rëndësinë e planifikimit të personelit, për kryerjen me sukses të aktivitetit;
11. Të rendisë detyrat e sektorit të teknikës, në organizimin e aktiviteteve;
12. Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit dhe plotësimit të kërkesave të veçanta të organizatorëve, për aktivitetet MICE dhe të aktivitete të tjera;
13. Të shpjegojë rëndësinë e plotësimit të listës së kontrollit për realizimin e detyrave paraprahe për organizimin e aktivitetit sipas llojit;
14. Të listojë llojet e shërbimit të ushqimit dhe pijeve që ofrohen në aktivitete;
15. Të shpjegojë rëndësinë e menaxhimit dhe monitorimit të aktiviteteve të organizuara;
16. Të shpjegojë rëndësinë e matjes së indeksit të kënaqësisë së klientëve, për aktivitetin e realizuar;
17. Të argumentojë rëndësinë e kryerjes së një analize të detajuar pas përfundimit të aktivitetit;
18. Të shpjegojë rëndësinë e risistemimit të sallës pas përfundimit të aktivitetit.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të organizojë aktivitete MICE dhe aktivitete të tjera.

Kriteret e vlerësimit

- Harton planin e punës me objektiva për realizimin me sukses të aktivitetit, sipas pritshmërisë të klientit;
- Komunikon me klientët për kërkesa të detajuara për aktivitetin (afatet kohore, sallën, detyrimet ligjore dhe buxhetet), sipas listës së kontrollit;
- Shpërndan fletët funksionale tek departamentet dhe sektorët e tjerë, sipas standardit;
- Skicon sallën, sipas llojit të aktivitetit, numrit të pjesëmarrësve si dhe kërkesave të klientit;
- Përdor elementë të dizajnit dhe të estetikës në dekorimin e sallës dhe tavolinave, sipas llojit të

- aktivitetit;
- Bashkërendon punën me sektorin e teknikës për realizimin e detyrave, sipas rregullores së brendshme;
- Bashkëpunon me departamente dhe sektorë të tjerë për plotësimin e kërkesave të veçanta të organizatorëve, sipas rregullores së brendshme;
- Verifikon realizimin e detyrave paraprake, sipas listës së kontrollit;
- Monitoron realizimin e shërbimit të ushqimit dhe pijeve të planifikuara për aktivitetin, sipas rregullit;
- Mat indeksin e kënaqësisë së klientëve për aktivitetin e realizuar, sipas politikave të kompanisë;
- Monitoron risistemimin e sallës pas përfundimit të aktivitetit, sipas rregullit.

NjN-07-III-0160-24 Bazat e kuzhinës

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë historinë e zhvillimit të kuzhinës nga lashtësia deri sot;
2. Të përshkruajë teknikat kryesore dhe bashkëkohore të gatimit;
3. Të përshkruajë karakteristikat e lëndëve të para që përdoren në kuzhinë;
4. Të përshkruajë proceset e përpunimit të ftohtë lëndëve të para dhe ndihmëse në kuzhinë;
5. Të përshkruajë teknikat e marinimit të lëndëve të para dhe ndihmëse në kuzhinë;
6. Të shpjegojë rëndësinë e erëzimit, dressing-ut dhe shijëzimit të lëndëve të para, ndihmëse, produkteve gjysmë të gatshme;
7. Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të sasisë së përbërësve dhe rregullave të kombinimit të tyre në gatesa;
8. Të shpjegojë rëndësinë e përgatitjes së gatesave për klientë me kërkesa të veçanta;
9. Të shpjegojë etapat e procesit teknologjik për përgatitjen e gatesave sipas menu-së dhe llojit të aktivitetit;
10. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të temperaturave të shërbimit të ushqimeve;
11. Të shpjegojë shkaqet kryesore të kontaminimit të ushqimit.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të kryejë parapërgatitje (Mise-en Place) në kuzhinë;
2. Të zbatojë etapat e procesit teknologjik për përgatitjen e gatesave sipas menu-së dhe llojit të aktivitetit.

Kriteret e vlerësimit

- Kryen parapërgatitje në kuzhinë, sipas rregullit;
- Kryen veprimtari sipas planit ditor të punës;
- Përzgjedh mjetet e punës në kuzhinë, sipas recetës;
